



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, me datë, 18.06.2024, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **Znj.Lirije Dema**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Fitore Vishi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet znj.Lirije Dema dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.06.2024, Nr.09/1-952/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Fitore Vishi, e cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të punësimit në shërbimin civil.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Lirije Dema.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkalar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

**Prishtinë 18.06.2024**

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**  
**Kreshnik Radoniqi**